# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**www.qpz.gov.al**

| **Nr.117** | **27 gusht** | **2010** |
|---|---|---|


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.615, datë 8.7.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar ........ | 5799 |
| Vendim i KM nr.616, datë 8.7.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura", të ndryshuar ........ | 5801 |
| Vendim i KM nr.617, datë 8.7.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar ........ | 5802 |
| Vendim i KM nr.618, datë 8.7.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e atasheve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare", të ndryshuar ........ | 5804 |
| Vendim i KM nr.619, datë 8.7.2010 | Për një ndryshim në vendimin nr.718, datë 23.6.2009 "Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse, në shërbimin e kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme" ........ | 5805 |
| Vendim i KM nr.620, datë 8.7.2010 | Për disa ndryshime në vendimin nr.1092, datë 2.7.2008 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të doganave" ........ | 5807 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.621, datë 8.7.2010 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.717, datë 23.6.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" ............................................... | 5809 |
| Vendim i KM nr.622 datë 8.7.2010 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës", të ndryshuar | 5811 |
| Vendim i KM nr.665, datë 4.8.2010 | Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Këshillit Tatimor, si dhe të kontributeve financiare të anëtarëve, që përfaqësojnë tatimpaguesit në këtë Këshill ...... | 5829 |
| Udhëzim i MF nr.27, datë 18.8.2010 | Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" .................................................................. | 5834 |

**VENDIM**
**Nr.615, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 "Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 5/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5/1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë për "kushte pune", prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

| | **Vitet e shërbimit** | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| OFICERË | Nën 2 | Mbi 2 | Mbi 3 | Mbi 4 | Mbi 6 | Mbi 8 | Mbi 10 | Mbi 12 | Mbi 14 | Mbi 16 | Mbi 18 | Mbi 20 | Mbi 22 | Mbi 24 | Mbi 26 |
| Gj. Lejtnant (Admiral) | | | | | | | | | | | | | | | 151500 |
| Gj. Major (Nënadmiral) | | | | | | | | | | | | | | 142390 | 145000 |
| Gj. Brigade (Kundëradmiral) | | | | | | | | | | | | | 112000 | 114000 | 114000 |
| Kolonel (Kapiten i rangut I-rë) | | | | | | | | | | | 88500 | 90000 | 92000 | 93600 | 96000 |
| Nënkolonel (Kapiten i rangut II-të) | | | | | | | | | 69700 | 71000 | 72200 | 73450 | 74650 | 75900 | 77100 |
| Major (Kapiten i rangut III-të) | | | | | | | 54600 | 55650 | 56600 | 57550 | 59300 | 60850 | 61650 | | |
| Kapiten (Kapiten lejtnant) | | | | 48900 | 49500 | 50150 | 50750 | 51400 | 52000 | 52650 | 53250 | | | | |
| Toger (Lejtnant) | | | 45250 | 46300 | 47300 | 48350 | 48900 | | | | | | | | |
| Nëntoger (Nënlejtnant) | 41300 | 42100 | 42900 | 43650 | 44400 | 45200 | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| | **Vitet e shërbimit** | | | | | | | | | | | | | | |
| NËNOFICERË | Nën 2 | Mbi 2 | Mbi 3 | Mbi 4 | Mbi 6 | Mbi 8 | Mbi 10 | Mbi 12 | Mbi 14 | Mbi 16 | Mbi 18 | Mbi 20 | Mbi 22 | Mbi 24 | Mbi 26 |
| K/Kapter | | | | | | | | | | | 49920 | 50960 | 52520 | 53560 | 54600 |
| Kapter | | | | | | | | 42430 | 43890 | 44650 | 45240 | 46800 | 48880 | | |
| Rreshter | | | | | | 37230 | 38790 | 41180 | 42430 | 43890 | 44650 | | | | |
| Tetar | | | | 35280 | 36230 | 36750 | 37590 | 38330 | 39170 | 40100 | 40850 | | | | |
| Nëntetar | 30450 | 31080 | 32350 | 33600 | 35280 | 36540 | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| | **Vitet e shërbimit** | | | | | | | | | | | | | | |
| USHTARË PROFESIONISTË | Nën 2 | Mbi 2 | Mbi 3 | Mbi 4 | Mbi 6 | Mbi 8 | Mbi 10 | Mbi 12 | Mbi 14 | Mbi 16 | Mbi 18 | Mbi 20 | Mbi 22 | Mbi 24 | Mbi 26 |
| Ushtar/detar profesionist II | 30350 | 31600 | 32860 | 34150 | 35280 | | | | | | | | | | |
| Ushtar/detar profesionist I | 27830 | 29100 | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| USHTARË TË SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM E STUDENTË USHTARAKË | | | | | | | | | | | | | | | |
| | **Vitet e shërbimit** | | | | | | | | | | | | | | |
| | Nën 2 | Mbi 2 | Mbi 3 | Mbi 4 | Mbi 6 | Mbi 8 | Mbi 10 | Mbi 12 | Mbi 14 | Mbi 16 | Mbi 18 | Mbi 20 | Mbi 22 | Mbi 24 | Mbi 26 |
| Ushtar rekrut II/detar II | 2000 | | | | | | | | | | | | | | |
| Ushtar rekrut I/detar I | 1500 | | | | | | | | | | | | | | |
| Studentë ushtarak | 1500 | | | | | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr.616, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.901, datë 19.12.2007, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

c) Shkronja "c" e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c. Paga e pozicionit "Sekretar i titullarit", "Sekretar i organit kolegjial drejtues", është 55 900 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionet "Sekretar i titullarit", "Sekretar i organit kolegjial drejtues", jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.".

ç) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. "Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit", apo "Drejtorët", të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë për "kushte pune", prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, pas miratimit rast pas rasti, nga njësitë e personelit të çdo institucioni.".

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të miratuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| PAGA MUJORE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **KLASA** | **POZICIONI** | **KATEGORITË** | **PAGA INDIVIDUALE PAGA BAZË** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
| | | | **Paga e grupit (PG) lekë** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje** | **Shtesa për kualifikim (SHK) lekë** | **Shtesa e pozicionit (SHP) lekë** |
| I | Sekretar i Përgjithshëm | I-b | 1 | 2% | | 115 000 |
| II | Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme | II-a | 1 | 2% | | 105 000 |
| | Drejtor drejtorie | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| III | Përgjegjës sektori Inspektori i auditimit të brendshëm | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| | Përgjegjës sektori | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| | Specialist i nivelit të lartë. Inspektor i auditimit të brendshëm | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 |
| IV | Specialist i nivelit të mesëm | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| | Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr.4

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

| **Grupi i diplomës** | **Lloji i diplomës** | **Vlera** |
|---|---|---|
| 1 | Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)<br>Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND)<br>Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12 000 lekë |
| 2 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP) | 11 000 lekë |
| 3 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP)<br>Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10 000 lekë |

**VENDIM**
**Nr.617, datë 8.7.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1 "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë", që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 2/I ndryshohet si më poshtë vijon:

"2/I. Paga e grupit, sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës, është si vijon:

Grupi 1- 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:

- Diplomë e Nivelit të Dytë (DND);
- Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND);
- Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

Grupi 2-10 000 (dhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:

- Diplomë e Nivelit të Parë (DNP);
- Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli "Mësues i shkollës fillore";
- Diplomë e shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi;
- Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga MASH-i, si dhe të gjithë ata që kanë mbaruar dy vite akademike të shkollës së lartë.

Grupi 3 - 8 000 (tetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen diplomat e shkollës së mesme.".

2. Efektet financiare për vitin 2010, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

| | **EMËRTIMI** | **PAGA MUJORE** | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Drejtor i shkollës së mesme<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë<br>Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore<br>Drejtor i konvikteve | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 49 000 |
| 2 | Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme<br>Përgjegjës i bazës prodhuese<br>Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë<br>Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë<br>Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 44 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 42 000 |
| 4 | Drejtor i shkollës 9-vjeçare | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 40 000 |
| 5 | Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV<br>Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive<br>Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare. | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 37 500 |
| 6 | Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 36 000 |
| 7 | Drejtor i kopshtit me ushqim | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 36 000 |
| 8 | Drejtor i kopshtit pa ushqim | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 33 000 |
| 9 | Mësues në shkollat e mesme<br>Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë<br>Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë<br>Mësues në shkollat me probleme të larta mendore | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 35 000 |
| 10 | Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 34 000 |
| 11 | Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX<br>Edukator konvikti<br>Kujdestar konvikti | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 32 000 |
| 12 | Edukator në kopësht fëmijësh | 1 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 29 000 |
| 13 | Mësues | 2 ose 3 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 26 000 |
| 14 | Edukator në kopësht fëmijësh | 2 ose 3 | 2% e PG | 5% e P.G<br>10% e P.G.<br>20% e P.G.. | 24 500 |

## VENDIM
## Nr.618, datë 8.7.2010

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| **Emërtimi** | **Paga në euro** | **Paga në dollarë** | **Shtesa për përfaqësimin (në%)** |
|---|---|---|---|
| Përfaqësitë e NATO-s | | | |
| Gj. Lejtnant | 1170 | 1410 | 75% |
| GJ. Major | 1145 | 1365 | 60-75% |
| Gj. Brigade | 1070 | 1285 | 60-75% |
| Përfaqësitë e tjera | | | |
| Kolonel | 960 | 1165 | 40-60% |
| Nënkolonel | 910 | 1100 | 40-60% |
| Major | 865 | 1050 | 40% |
| Kapiten | 805 | 1020 | 40% |
| Toger | 760 | 925 | 40% |
| Nëntoger | 705 | 875 | 40% |
| K/kapter | 760 | 925 | 40% |
| Kapter | 680 | 820 | 40% |
| Rreshter | 580 | 680 | 40% |
| Tetar | 470 | 575 | 40% |
| Nëntetar | 420 | 520 | 40% |

## VENDIM
## Nr.619, datë 8.7.2010

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 23.6.2009 "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.718, datë 23.6.2009, bëhen shtesat e ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1 "Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm", e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

b) Lidhja nr.2 "Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm", e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Paga e grupit (kolona 4) e lidhjes nr.2, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

| Nr. | Grada | Funksionet organike | Paga bazë për gradë | Shtesa për natyrë të veçantë pune |
|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Asistent | Ndihmësspecialist në provë në trupën operacionale | 35 600 | 6 500 |
| 2 | Agjent | Ndihmësspecialist në trupën operacionale | 38 700 | 8 000 |
| 3 | Agjent i I-rë | Drejtues grupi/ndihmësspecialist në trupën operacionale | 43 700 | 8 000 |
| 4 | Hetues | Specialist hetimi në nivel vendor Specialist hetimi në nivel vendor në provë | 53 100 | 8 000 |
| 5 | Hetues i I-rë | Specialist hetimi në nivel vendor | 66 200 | 8 000 |
| | Hetues i I-rë | Specialist hetimi në nivel qendror<br>Shef seksioni në nivel qendror<br>Shef sektori në nivel vendor | 75 300 | 10 000 |
| 6 | Drejtues | Shef seksioni në nivel qendror<br>Shef sektori në nivel vendor<br>Shef sektori në nivel qendror | 81 600 | 10 000 |
| 7 | Drejtues i I-rë | Shef sektori në nivel qendror<br>Drejtor drejtorie në nivel vendor<br>Drejtor drejtorie në nivel qendror | 91 600 | 10 000 |
| 8 | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm | Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të Hetimit) | 96 400 | 15 000 |
| 9 | Drejtor i Përgjithshëm | Drejtor i Përgjithshëm | 104 400 | 20 000 |

Lidhja nr.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

| Nr. | Klasifikimi i niveleve | Funksionet organike | Kategoria e pagës | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa e pozicionit | Shtesa për natyrë të veçantë pune |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 1 | Punonjës të nivelit të lartë drejtues | Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit | II-b | 1 | 2% | 88 000 | |
| | | | | | | | |
| 2 | Punonjës të nivelit të mesëm drejtues | Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse) | III-a | 1 | 2% | 71 000 | |
| | | | | | | | |
| 3 | Punonjës të nivelit bazë drejtues | Shef sektori në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit) | III-a | 1 | 2% | 71 000 | 5000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Punonjës të nivelit bazë zbatues | Inspektor në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit) | III-b | 1 ose 2 | 2% | 54 000 | 5000 |
| | | Specialist në nivel qendror | III-b | 1 ose 2 | 2% | 54 000 | |
| | | | | | | | |
| | | Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së | IV-a | 1 ose 2 | 2% | 43 000 | 5000 |
| | | | | | | | |
| | | Specialist në nivel qendror | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 43 000 | |
| | | | | | | | |
| | | Specialist në nivel qendror | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 33 000 | |

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)<br>Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND)<br>Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12 000 lekë |
| 2 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP) | 11 000 lekë |
| 3 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP)<br>Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10 000 lekë |

## VENDIM
## Nr.620, datë 8.7.2010

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1092, DATË 2.7.2008 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DOGANAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1092, datë 2.7.2008, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagave të sistemit doganor”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e doganave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohet Minisria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË DOGANAVE

| PAGA MUJORE | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Pozicioni** | | **Paga individuale** | | | **Shtesa e pozicionit** | |
| **Klasifikimi doganor** | | **Kategoria** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | **Shtesa për kushte pune** |
| | Titullar i institucionit | II-a | 1 | 2% | 0 | 105 000 | 20 000 |
| | Zv/drejtor i përgjithshëm | II-b | 1 | 2% | 0 | 88 000 | 15 000 |
| A | Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastër | III-a | 1 | 2% | 0 | 71 000 | 15 000 |
| B | Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë-Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës. | III-a/1 | 1 | 2% | 0 | 62 000 | 14 000 |
| C1 | Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabandë. Specialist laboratori. Specialist, jurist, administrator rrjeti. | III-b | 1 ose 2 | 2% | 0 | 54 000 | 14 000 |
| | Financiernë degë doganore, Përkthyes, Koordinator në DOH, Specialist i imarrëdhënieve ndërkombëtare. | III-b | 1 ose 2 | 2% | 0 | 54 000 | 12 000 |
| C2 | Doganier kontrolli dokumentar fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laboratori. Llogarotar. | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | 0 | 43 000 | 12 000 |
| C3 | Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist. | | | 1% | | 35 000 | 7 000 |
| D1 | Magazinier. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik. | | | 1% | | 30 000 | 3 500 |
| D2 | Punëtor mirëmbajtës | | | 1% | | 20 600 | 3 000 |
| D3 | Punonjës pastrimi | | | 1% | | 19 000 | |

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)<br>Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND)<br>Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12 000 lekë |
| 2 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP) | 11 000 lekë |
| 3 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP)<br>Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10 000 lekë |

**VENDIM**
**Nr.621, datë 8.7.2010**

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.717, DATË 23.6.2009 "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja I "Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura", e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 "Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore", e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në lidhjen I/1 "Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës, për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura", të shtohet emërtesa "Anketues në INSTAT, klasa V".

ç) në lidhjen I/8 "Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në institucionet qendrore në varësi të Ministrit të Mbrojtjes të grupit të parë e të dytë", shtohen emërtimet e mëposhtme:

"Ofsetist në Institutin Gjeografik të Ushtrisë, klasa VIII";

"Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton, klasa V. ".

d) Paragrafi i dytë i pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Këto shtesa, për të katër shkallët, llogariten mbi pagën bazë të klasës VI, të lidhjeve përkatëse.".

dh) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11.a Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin "A", për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të cilët, në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë", kanë në dispozicion shoferë që nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, përfitojnë pagën sipas klasës VII të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 13 500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

b) Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “B” dhe në grupin “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, të cilët në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë”, kanë në dispozicion shofer, përfitojnë pagën sipas klasës VI të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 9500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

c) Shoferët e titullarëve të tjerë, të cilët në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë”, kanë në dispozicion shoferë, përfitojnë pagën sipas klasës V të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 6500 (gjashtë mijë e pesëqind) lekë në muaj.”.

e) Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Punonjësit në pozicionin “Shofer - mekanik” në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në Ministrinë e Brendshme, përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 5000 (pesë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare për vitin 2010, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr. I

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE NË PREFEKTURA

| Nr. rendor | Klasa | Paga bazë mujore në lekë |
|---|---|---|
| I | I | 19 000 |
| 2 | II | 20 700 |
| 3 | III | 21 700 |
| 4 | IV | 22 300 |
| 5 | V | 23 500 |
| 6 | VI | 25 500 |
| 7 | VII | 27 500 |
| 8 | VIII | 30 500 |
| 9 | IX | 34 000 |
| 10 | X | 36 500 |

Lidhja nr. II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

| Nr. rendor | Klasa | Paga bazë mujore në lekë |
|---|---|---|
| 1 | I | 19 000 |
| 2 | II | 20 700 |
| 3 | III | 21 700 |
| 4 | IV | 22 300 |
| 5 | V | 23 500 |
| 6 | VI | 24 500 |
| 7 | VII | 25 000 |
| 8 | VIII | 25 600 |

| | | |
|---|---|---|
| 9 | IX | 27 200 |
| 10 | X | 28 500 |
| 11 | XI | 29 500 |
| 12 | XII | 31 500 |
| 13 | XIII | 33 000 |
| 14 | XIV | 35 000 |

**VENDIM**
**Nr.622 datë 8.7.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës "a" të pikës 1, shfuqizohet emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil" dhe shtohet emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme Detare."

2. Në shkronjën "c", të pikës 1, emërtesa "Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Durrës", shfuqizohet.

3. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Lidhja nr.1/2, që përmendet në pikën 2/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Lidhja nr.1/3, që përmendet në pikën 2/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Lidhja nr.1/4, që përmendet në pikën 2/4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Lidhja nr. 1/5, që përmendet në pikën 2/5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Lidhja nr.1/6, që përmendet në pikën 2/6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Lidhja nr.1/7, që përmendet në pikën 2/7, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Lidhjet nr.2/1-A dhe 2/1-B, që përmenden në pikën 3/1, të zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

13. Lidhja nr.2/2, që përmendet në pikën 3/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Lidhja nr.2/3, që përmendet në pikën 3/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

15. Lidhjet nr.2/4-a dhe 2/4-b, që përmenden në pikën 3/4, të zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

16. Lidhja nr.2/5, që përmendet në pikën 3/5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Lidhja nr.3, që përmendet në pikën nr.4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Lidhja nr.3/1, që përmendet në pikën 4/1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

19. Lidhja nr.4, që përmendet në pikën 5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë perbërëse e tij.

20. Lidhja nr.4/1, që përmendet në pikën 5/1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë perbërëse e tij.

21. Lidhja nr.4/2, që përmendet në pikën 5/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet ketij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

22. Lidhja nr.4/3, që përmendet në pikën 5/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërese e tij.

23. Lidhja nr.4/4, që përmendet në pikën 5/4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Lidhja nr.4/5, që përmendet në pikën 5/5, shfuqizohet.

25. Lidhja nr.4/6, që përmendet në pikën 5/6, të zëvendësohet me lidhjen nr. 4/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

26. Lidhja nr. 4/7, qe përmendet në pikën 5/7, të zëvendësohet me lidhjen numër 4/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

27. Lidhja nr.4/8, që përmendet në pikën 5/8, të zëvendësohet me lidhjen numër 4/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

28. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi, është sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

29. Paragrafi i parë dhe i parafundit i pikës 12, ndryshohen si më poshtë vijon:

""Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit" apo "Drejtorët", në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione pune që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë për "kushte pune", 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.".

"Punonjësit e degëve të thesarit, që punojnë në sistemin AMoFTS, përfitojnë një shtesë për kushte pune mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, si më poshtë:

a) 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për pozicionin përgjegjës i degës së thesarit, Tiranë;

b) 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj për degën e thesarit, Tiranë;

c) 5000 (pesë mijë) lekë në muaj për degët e tjera të thesarit.".

30. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, për:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Detare, të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë. Përjashtimisht për periudhën nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë deri në datën 1 korrik 2010, vlerat e kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni të jenë sipas vendimit nr.606, datë 27.4.2009 të Këshillit të Ministrave. Efektet financiare për deri në datën 1 korrik për këtë institucion, të përballohen nga fondet e miratuara për të, për vitin 2010.

- Të gjitha parashikimet e tjera, të fillojnë nga data 1 korrik 2010.

31. Efektet financiare për vitin 2010, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

- për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të përballohen nga fondet e parashikuara për vitin 2010 për këtë sistem;

- për të gjitha parashikimet e tjera, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikat e rritjes së pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË PARË

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | II-a | 1 | 2% | | 105 000 |
| Zv/titullar i institucionit Inspektor në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Drejtor drejtorie, anëtar i Komitetit Shteteror të Kulteve, menaxher trajnimi, kapiteni i porteve | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Përgjegjës sektori, kapiteni i portit | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 1/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË ZYRËN QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

| **POZICIONI** | **KATEGO RIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNE** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Kryeregjistruesi | II-a | 1 | 2% | | 105 000 | 13 000 |
| Zëvendëskryeregjistruesi | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 13 000 |
| Drejtor drejtorie | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 15 000 |
| Përgjegjes sektori | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 10 000 |
| Pergjegjes sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Specialist. | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 10 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 5 000 |

Lidhja nr. 1/2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

| POZICIONI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT | SHTESA PËR KUSHTE PUNE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) | |
| Titullar i institucionit. | II-a | 1 | 2% | | 105 000 | 10 000 |
| Zevendestitullar i institucionit. | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 8 000 |
| Drejtor i drejtorisë së SHKBB | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 15 000 |
| Drejtor drejtorie. | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 6 000 |
| Përgjegjës sektori në drejtorine e SHKBB | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 10 000 |
| Përgjegjës sektori. | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 6 000 |
| Pergjegjes sektori. | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 0 |
| Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 | 0 |
| Specialist/inspektor në Drejtorine e SHKBB | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 | 10.000 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose_3 | 2% | | 43 000 | 5.000 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 0 |
| Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 0 |

Lidhja nr. 1/3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE INFORMALE

| POZICIONI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT | SHTESA PËR KUSHTE PUNE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) | |
| Titullar i institucionit | II-a | 1 | 2% | | 105 000 | 13 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 13 000 |
| Drejtor drejtorie | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 15 000 |
| Përgjegjës sektori Koordinator | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 10 000 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 10 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose_3 | 2% | | 33 000 | 5 000 |

Lidhja nr. 1/4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNE** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Titullari i institucionit | II-a | 1 | 2% | | 105 000 | 13 000 |
| Zëvendëstitullari i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 13 000 |
| Përgjegjës sektori | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 10 000 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 | 5 000 |
| Specialist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 10 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 5 000 |

Lidhja nr. 1/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR I INSTITUCIONIT" NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

| **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) |
| Titullar i institucionit | II-a | 1 | 2% | | 105 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Përgjegjës departamenti | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes Drejtor në drejtoritë mbështetëse | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Specialist pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Specialist zbatues pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes Specialist në sektorët mbështetës | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 1/6

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNË** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Drejtor i përgjithshëm | II-a | 1 | 2% | | 105 000 | 12 000 |
| Zv/drejtor i Përgjithshëm | II-b | 1 | 2% | | 88 000 | 12 000 |
| Përgjegjës sektori në drejtori | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 15 000 |
| | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 15 000 |
| Përgjegjës sektori mbështetës | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 | 0 |
| | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 0 |
| Specialist në drejtori | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 15 000 |
| Specialist mbështetës | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 0 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 0 |

Lidhja nr. 1/7

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË INSTITUTIN GJEOGRAFIK TË USHTRISË, SHTABIN E PËRGJITHSHËM, KOMANDËN E SHTABIT TË FORCËS SË BASHKUAR, SHTABIT TË KOMANDËS MBËSHTETËSE, SHTABIT TË KOMANDËS SË DOKTRINËS DHE STËRVITJES

| **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | II-a | 1 | 2% | | 105 000 |
| Zëvendestitullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Përgjegjës departamenti, në Institutin Gjeografik të Ushtrisë | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Shef dege të auditimit të brendshëm | III-a/l | 1 | 2% | | 62 000 |
| Përgjegjës/shef sektori shef dege | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Inspektor auditi | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 |
| Specialist Mjek në strukturat e forcave të armatosura. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË DYTË

| **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit Drejtor ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Kancelar në universitet | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Zv/titullar i institucionit | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Drejtor drejtorie<br>Ekspert mjeko -<br>ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore<br>- Inspektor në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit | | | | | |
| Drejtor drejtorie<br>- Kryeredaktor në Qendrën e Publikimeve Zyrtare<br>- Përgjegjës sektori<br>- Ekspert toksikologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore.<br>- Ekspert psikiatër-ligjor në Institutin e Mjekësisë ligjore.<br>- Ekspert biologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë ligjore<br>- Ekspert mjeko-ligjor pranë gjykatave të apelit<br>Drejtor i bibliotekës shkencore të universiteteve<br>- Kancelar në fakultet | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| - Përgjegjës sektori<br>- Kryetar dege në rektorat | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| - Redaktor i Qendrës se Publikimeve Zyrtare<br>- Inspektor | III-b | 1 ose 2 | 2% | | 54 000 |
| - Kryetar dege në fakultet<br>Përgjegjës biblioteke në universitete dhe shkollat e tjera të larta<br>- Përgjegjës sektori në rektorat<br>- Përgjegjës sektori në bibliotekën shkencore të universitetit<br>- Kryesekretar në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |
| - Specialist në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit -<br>Sekretar i kualifikimit shkencor në Shkollën e Magjistraturës<br>- Klasifikator dhe kryebibliotekar në universitete dhe shkollat e tjera të larta<br>- Bibliograf në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Specialist<br>Informaticien në Qendrën e Publikimeve Zyrtare<br>Informaticien në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit<br>Korrektor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare<br>Kurator<br>Inspektor<br>Bibliograf<br>Klasifikator<br>Bibliotekar<br>Restaurator<br>Lektor<br>Administrator<br>Redaktor<br>Studiues | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |
| Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit<br>Bibliotekar në biblioteken e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes<br>Laborant me arsim të lartë në universitete dhe shkollat e tjera të larta.<br>Sekretar mësimor.<br>Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 2/1-A

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR DHE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FEMIJË

| **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) |
| Titullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Zv/titullar i institucionit<br>Drejtor drejtorie | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Përgjegjës sektori | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Specialist<br>Mjek | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 2/1-B

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR DHE NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE, NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURES PËR FËMIJË

I. Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operas dhe Baletit, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor

| Nr. | Pozicioni | Paga |
|---|---|---|
| 1 | Dirigjent<br>Regjisor<br>Solist i parë<br>Koncertmaestër<br>Baletmaestër<br>Aktor i parë | 74 000 lekë |
| 2 | Asistent dirigjent.<br>Asistent regjisor.<br>Solist II (spala sektori).<br>Aktor i dytë. | 66 000 lekë |
| 3 | Orkestrant i kategorisë së parë.<br>Korist i kategorise së parë.<br>Balerin i kategorisë së parë.<br>Skenograf i kategorisë së parë. | 55 000 lekë |
| 4 | Aktor i tretë. | 54 000 lekë |
| 5 | Orkestrant i kategorisë së dytë.<br>Korist i kategorisë së dytë.<br>Balerin i kategorisë së dytë.<br>Skenograf i kategorisë së dytë. | 45 000 lekë |

II. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë

| Nr | Pozicioni | Paga |
|---|---|---|
| 1 | Dirigjent<br>Regjisor | 66 000 lekë |
| 2 | Solist i parë<br>Orkestrant i kategorisë së parë<br>Aktor i parë<br>Skenograf i kategorisë së parë<br>Korist i kategorisë së parë<br>Valltar i kategorisë së parë | 55 000 lekë |
| 3 | Solist i dytë<br>Orkestrant i kategorisë së dytë<br>Aktor i dytë<br>Skenograf i kategorisë së dytë<br>Korist i kategorisë së dytë<br>Valltar i kategorisë së dytë | 45 000 lekë |

Lidhja nr. 2/2

## STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR I INSTITUCIONIT", NË QENDRAT E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 8 8.000 |
| Përgjegjës departamenti | III-a | 1 | 2% | | 71.000 |
| Përgjegjes sektori, në sektoret e përmbajtjes | III-a/1 | 1 | 2% | | 62.000 |
| Përgjegjes sektori, në sektorët mbështetës<br>Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes | III-b | 1 | 2% | | 54.000 |
| Specialist pa grada e tituj shkencore në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43.000 |
| Specialist zbatues pa grada e tituj shkencore në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes<br>Specialist në sektorët mbështetës | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33.000 |

Lidhja nr. 2/3

## STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË SHËRBIMIN INFORMATIV USHTARAK

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Drejtor (titullar i institucionit) | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Zv/drejtor operacional<br>Zv/drejtor mbështetës.<br>Shef shërbimi operacional | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Shef sektori operacional.<br>Shef sektori mbështetës. | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| Shef zyre drejtori<br>Shef/përgjegjës zyre operacional.<br>Shef/përgjegjës zyre mbështetëse.<br>Inspektor i Përgjithshëm.<br>Këshilltar juridik. | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Specialist.<br>Analist | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| Inspektor. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 2/4-a

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË QENDRËN KULTURORE TË USHTRISË

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për Kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |
| Zv/titullar i institucionit | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Udhëheqës artistik | III-a/1 | 1 | 2% | | 62 000 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Specialist<br>Mjek | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 2/4-b

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË QENDRËN KULTURORE TË USHTRISË

| **Nr.** | **Pozicioni** | **Paga** |
|---|---|---|
| 1 | Dirigjent<br>Regjisor | 66 000 lekë |
| 2 | Instrumentist<br>Vokalist | 55 000 lekë |

Lidhja nr. 2/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT”, NË QENDRËN E SHTYPIT DHE TË BOTIMEVE, AKADEMINË E NËNOFICERËVE “TOMSON”, INSTITUTIN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË MBROJTJES, SHKOLLËN E TRUPËS, ARKIVIN QENDROR, QENDRËN E ZBULIMIT RADIOTEKNIK, SHTABIN E BRIGADËS SË REAGIMIT TË SHPEJTË, BRIGADËS DETARE, BRIGADËS AJRORE, BRIGADËS SË MBESHTETJES RAJONALE, BRIGADËS LOGJISTIKE, BRIGADËS SË STËRVITJES BAZË, REGJIMENTIT TË HELIKOPTERËVE, REGJIMENTIT KOMANDO, REGJIMENTIT TË INFRASTRUKTURËS, REGJIMENTIT TË MBËSHTETJES SË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM, KOMANDËS SË QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT. QENDRAT E RIPARIMIT TË NIVELIT TË TRETË DHE TË KATËRT TË PAJISJEVE TOKËSORE DHE AJRORE DHE KANTIERIN E NDËRTIMIT TË ANIJEVE PASHALIMAN

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | II-b | 1 | 2% | | 88 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Zëvendëstitullar<br>Kryeinxhiner në Kantierin e Ndërtimit të Anijeve Pashaliman.<br>Drejtor | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Kryeinxhinier | III-a/l | 1 | 2% | | 62 000 |
| Pergjegjes sektori<br>Kryeredaktor. | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Shef zyre<br>Zëvendësshef | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |
| Specialist<br>Redaktor | IV-b | 1 ose<br>2<br>ose 3 | 2% | | 33 000 |

Lidhja nr. 3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË TRETË

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit | III-a | 1 | 2% | | 71 000 |
| Drejtor drejtorie | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Përgjegjës sektori. | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |
| Inspektor | IV-a | 1 ose 2 | 2°/o | | 43 000 |
| Specialist<br>Restaurator<br>Lektor<br>Arkivist/Katalogist<br>Historian | IV-b | 1 ose 2<br>ose 3 | 2% | | 33 000 |
| | IV-c | 1 ose 2<br>ose 3 | 2% | | 25 000 |

Lidhja nr. 3/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË POZICIONET "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR I INSTITUCIONIT", NË LABORATORIN QENDROR TË FORCAVE TË ARMATOSURA, BATALIONET NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA, KOMPANITË MBËSHTETËSE TË KOMANDAVE, BRIGADAVE DHE REGJIMENTEVE, BAZA AJRORE NDIHMËSE NË KUÇOVË, BAZA AJRORE RINAS, PARKU I VETURAVE, SHTËPITË E PUSHIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

| PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Drejtor i laboratorit | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Përgjegjës/shef sektori | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Specialist të kontrollit të hapësirës detare | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |
| Specialist Mjek | IV-c | 1 ose 2 ose3 | 2% | | 25 000 |

Lidhja nr. 4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS, TË INSTITUCIONEVE RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE TË PËRCAKTUARA NË PIKËN 1, TË INSTITUCIONEVE VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE RAJONALE, TË PUNONJËSVE QË KRYEJNË FUNKSIONE TË DELEGUARA TË PUSHTETIT QENDROR NË PUSHTETIN VENDOR, TË BORDEVE TË KULLIMIT, TË KOMISIONEVE VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

| **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetersi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Titullar i institucionit rajonal.<br>Kryetar i Zyrës së Përmbarimit<br>Drejtor i zyrës vendore të Shërbimit të Provës.<br>Përgjegjës i degëve të thesarit në qendër qarku<br>Përgjegjes seksioni në seksionet e Administrimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në qarqe<br>Kryeinspektor në Inspektoratet e Mbrojtjes së Tokës në qarqe | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Titullar i institucionit vendor<br>Përgjegjës sektori në institucionet rajonale<br>Përgjegjes sektori në Degën e thesarit Tiranë<br>Përgjegjës të degëve vendore të thesarit<br>Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar)<br>Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |
| Përmbarues Gjyqësor në zyrat e Përmbarimit Gjyqësor<br>Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 |
| Përgjegjës Sektori i institucionit vendor<br>Përgjegjes i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar). | IV-b | 1 | 2% | | 33 000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Specialist i zyres së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar).<br>Specialist i gjendjes civile pranë prefektit<br>Specialist në institucionet rajonale<br>Restaurator arti<br>Arkitekt.<br>Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qarqe<br>Specialist në degët e thesarit<br>Inspektor punë<br>Inspektor të sistemit të Ministrisë së Buqjësisë | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |
| Specialist në institucionet vendore<br>Specialist i zyrës se gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar)<br>Restaurator<br>Instruktor<br>Piktor<br>Kontrollor pune | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 25 000 |

Lidhja nr. 4/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË RRETHE

| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNE** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetersi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Regjistrues i Tiranës | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 15 000 |
| Regjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë | III-a/l | 1 | 2% | | 62 000 | 16 500 |
| Regjistrues i rretheve të kategorisë së II-të<br>Zëvendesregjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 16 500 |
| Zevendesregjistrues në zyrat e kategorisë së II-të | IV-a | 1 | 2% | | 43.000 | 16 500 |
| Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë se I-rë. | IV-a | I | 2% | | 43 000 | 10 000 |
| Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të | IV-b | 1 | 2% | | 33 000 | 10 000 |
| Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 10 000 |
| Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorise se II-të. | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 25 000 | 6 000 |

Shënim: Zyrat e regjistrimit të kategorise se I-rë janë zyrat: Tiranë, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Dibër dhe Sarandë.

Lidhja nr. 4/2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAVE ARSIMORE

| | | | | | **PAGA MUJORE** |
|---|---|---|---|---|---|
| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore per vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SIIK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** |
| Drejtor i drejtorive arsimore rajonale | III-b | 1 | 2% | Shkalla e tretë- 10% Shkalla e dytë- 20% Shkalla e parë - 30% | 54 000 |
| Drejtor i zyrave arsimore. Përgjegjës sektori në drejtorite arsimore rajonale. | IV-a | 1 | 2% | Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë- 30% | 43 000 |
| Përgjegjes sektori në zyrat arsimore. | IV-b | 1 | 2% | Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë-20% Shkalla e parë - 30% | 33 000 |
| Specialist në drejtoritë arsimore rajonale. | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë-30% | 33 000 |
| Specialist në zyrat arsimore. | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | 2% | Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë-20% Shkalla e parë -30% | 25 000 |

Lidhja nr.4/3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORITË E BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E RIEDUKIMIT NË RRETHE

| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNE** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHy)** | **Shtesa për Kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Titullar i institucionit | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 10 000 |
| Zevendëstitullar i institucionit | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 8 000 |
| Përgjegjës Sektori | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 | 5 000 |
| Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 4 000 |

Lidhja nr. 4/4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE (DREJTORIVE) RAJONALE, TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

| **POZICIONI** | **KATEGORIA** | **PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | **SHTESA PËR KUSHTE PUNE** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa e pozicionit (SHP)** | |
| Drejtor i zyrës (drejtorisë) rajonale, Tiranë | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | 15 000 |
| Drejtor i zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së parë. Zv/drejtor i zyrës (drejtorise) rajonale, Tiranë | III-a/l | 1 | 2% | | 62 000 | 16 500 |
| Drejtor i Zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së dytë. Zv/drejtor i Zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së parë. | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | 16 500 |
| Pergjegjes Sektori në zyrat (drejtorite) rajonale | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 | 10 000 |
| Specialist në Zyrat (drejtoritë) rajonale | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 10 000 |

Shënim: Zyrat (drejtoritë) rajonale të kategorisë së parë të ALUIZNIT-t janë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Shkodër, Lezhë, Korçë, Berat.

Lidhja nr. 4/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË KOMISIONET VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

| POZICIONI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT | SHTESA PËR KUSHTE PUNE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit (SHP) | |
| Titullar i institucionit pranë prefektit të qarkut Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. | III-a | 1 | 2% | | 71 000 | |
| Titullar i institucionit pranë prefektit të qarkut Berat, Dibër, Gjirokastër, Kukës. | III-b | 1 | 2% | | 54 000 | |
| Specialist në Komisionet Vendore pranë prefektit të qarkut Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. | IV-a | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 43 000 | 5 000 |
| Specialist në komisionet vendore pranë prefektit të Qarkut Berat, Dibër, Gjirokastër, Kukës | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 | 5 000 |

Lidhja nr. 4/6

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË POZICIONET MBËSHTETËSE "SPECIALIST", "SHEF SEKSIONI" DHE "PËRGJEGJËS/SHEF SEKTORI", NË DREJTORITË E POLICISË NË QARQE, KOMISARIATE DHE REPARTE AUTONOME

| POZICIONI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| Përgjegjës/Shef sektori në drejtoritë e policisë së qarkut | III-b | 1 | 2% | | 54 000 |
| Shef seksioni në drejtoritë e policisë së qarkut, komisariate, apo reparte autonome | IV-a | 1 | 2% | | 43 000 |
| Specialist | IV-b | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 33 000 |
| | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 25 000 |

Lidhja nr. 4/7

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË POZICIONET "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR I INSTITUCIONIT" NË QENDRAT E REKRUTIMIT DHE MOBILIZIMIT DHE KOMANDAT E MBËSHTETJES RAJONALE TË SISTEMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

| POZICIONI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| Përgjegjës/shef sektori | IV-b | 1 | 2% | | 33 000 |
| Specialist | IV-c | 1 ose 2 ose 3 | 2% | | 25 000 |

Lidhja nr.6

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)<br>Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND)<br>Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12 000 lekë |
| 2 | Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP). | 11 000 lekë |
| 3 | Diplome e Nivelit të Parë (DNP) të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10 000 lekë |

## VENDIM
## Nr.665, datë 4.8.2010

## PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TATIMOR, SI DHE TË KONTRIBUTEVE FINANCIARE TË ANËTARËVE, QË PËRFAQËSOJNË TATIMPAGUESIT NË KËTË KËSHILL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 38/1 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA DHE DREJTIMI I KËSHILLIT TATIMOR

1. Përbërja e Këshillit Tatimor:

a) Këshilli Tatimor përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve 12 (dymbëdhjetë) janë përfaqësues të tatimpaguesve dhe 6 (gjashtë) janë përfaqësues të institucioneve publike, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

b) Përfaqësuesit e tatimpaguesve përbëhen nga përfaqësues të dhomave të tregtisë dhe industrisë, të shoqatave të tjera të biznesit, të shoqatave profesionale të ekspertëve kontabël, të shoqatave të tjera të organizuara mbi bazë profesioni, të rregulluara me ligj të veçantë, si dhe të organizatave të tjera jofitimprurëse, që përfaqësojnë grupe të mëdha tatimpaguesish.

c) Përfaqësuesit e institucioneve publike përbëhen nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

ç) Me propozimin e, të paktën, dy prej anëtarëve të Këshillit Tatimor dhe me miratimin e bashkëkryetarëve, me shkrim dhe/ose përmes postës elektronike, Këshilli mund të krijojë grupe pune të

përkohshme, për të shqyrtuar çështje që do të diskutohen në mbledhjet e tij dhe për të përgatitur materiale me shkrim për t'u shqyrtuar në këto mbledhje.

2.Për caktimin e anëtarëve, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, ndiqet kjo procedurë:

a) Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Ministria e Financave boton në median e shkruar, në dy gazeta ditore me qarkullim më të madh, për tri ditë radhazi, njoftimin për thirrjen e shprehjes së interesit për pjesëmarrje në Këshillin Tatimor, formën e aplikimit, si dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve përfaqësues të tatimpaguesve, në këtë Këshill. Afati maksimal i pranimit të dokumentacionit është 20 (njëzet) ditë nga data e fundit e botimit.

b) Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, përcaktohen në pikën 5 të kreut I të këtij vendimi.

c) Personi i kontaktit për mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të shprehjes së interesit është Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor.

ç) Komisioni i vlerësimit të dokumenteve të shprehjes së interesit përbëhet nga:

i) Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, në Ministrinë e Financave;

ii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

iii) Avokati i tatimpaguesve.

d) Drejtori i Përgjithshëm i Politikave makroekonomike dhe Fiskale, në Ministrinë e Financave, në emër të komisionit të vlerësimit të dokumenteve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga afati përfundimtar i pranimit të dokumentacionit, sipas përcaktimeve të shkronjës "a" të kësaj pike, i propozon Ministrit të Financave listën emërore të anëtarëve, që do të përfaqësojnë tatimpaguesit në Këshillin Tatimor.

dh) Ministri i Financave, brenda 7 (shtatë) ditë nga paraqitja e propozimit, miraton, me urdhër, listën e anëtarëve të Këshillit Tatimor, përfaqësues të tatimpaguesve.

3. Për caktimin e anëtarëve, përfaqësues të institucioneve publike, në Këshillin Tatimor, ndiqet kjo procedurë:

a) Përfaqësuesit e institicioneve publike, në Këshillin Tatimor, përbëhen nga 2 (dy) anëtarë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe 4 (katër) anëtarë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

b) Anëtarët, përfaqësues të Ministrisë së Financave, në Këshillin Tatimor, janë:

i) Zëvendësministri i Financave, që mbulon çështjet tatimore;

ii) Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale;

c) Anëtarët, përfqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në Këshillin Tatimor janë:

i) Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;

ii) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Operacioneve;

iii) Avokati i tatimpaguesve;

iv) Drejtori i Drejtorisë Teknike.

4. Statusi i anëtarëve të Këshillit Tatimor:

a) Anëtarët, përfaqësues të institucioneve publike, në Këshillin Tatimor, janë anëtarë të përhershëm të këtij Këshilli.

b) Anëtarët, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, janë anëtarë të përkohshëm të këtij Këshilli. Procedurat për ndryshimin e tyre përcaktohen në pikën 6 të kreut I të këtij vendimi.

5. Për përzgjedhjen e anëtarëve, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, ndiqen këto kritere:

a) Përfaqësimi i tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të marrë në konsideratë kriterin e përfaqësimit gjeografik të tatimpaguesve, të kategorive të ndryshme të tatimpaguesve, si dhe të sektorëve të ekonomisë ku ata zhvillojnë veprimtarinë.

b) Përfaqësuesit e tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i) të kenë përvojë profesionale prej jo më pak se 3 (tre) vjet në çështje të administrimit të biznesit në Shqipëri;

ii) të jenë anëtarë të një shoqate ose organizate të llojeve të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 1 të kreut I të këtij vendimi, dhe të autorizohen, me shkrim, nga titullari, për të përfaqësuar shoqatën ose organizatën;

iii) Të kenë përvojë të punës në grup dhe aftësi të mira komunikuese.

6. Mandati i anëtarëve përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, dhe ndryshimi i tyre:

a) Anëtarësia në Këshillin Tatimor i përket organizatës që një individ përfaqëson. Në rast largimi nga organizata që e ka emëruar si përfaqësues në këtë Këshill, personi i caktuar zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit.

b) Organizata anëtare, në Këshillin Tatimor, përfaqësuesi i së cilës nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, të Këshillit, e humbet të drejtën e anëtarësisë në këtë Këshill për dy vjet, nga momenti i humbjes së kësaj të drejte.

c) Anëtarët, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, kanë një mandat dyvjeçar. Organizatat anëtare, mandati i përfaqësuesit të të cilave ka përfunduar, kanë të drejtë të marrin pjesë në të dhe të përzgjidhen, përmes procesit të zëvendësimit të anëtarëve të Këshillit, të cilëve u ka mbaruar mandati.

ç) Dy anëtarë, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, largohen nga ky Këshill dy vjet pas mbledhjes themeluese të Këshillit. Përzgjedhja e tyre bëhet me short. Ata zëvendësohen nga dy anëtarë të rinj, përfaqësues të tatimpaguesve. Çdo vit pas këtij ndryshimi të parë, largohen dy anëtarë të tjerë, përfaqësues të tatimpaguesve të cilët kanë plotësuar mandatin dyvjeçar të anëtarësisë në këtë Këshill dhe zëvendësohen me dy anëtarë të rinj, përfaqësues të tatimpaguesve.

d) Përzgjedhja e anëtarëve të rinj, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, bëhet sipas së njëjtës procedurë për përzgjedhjen e anëtarëve të parë përfaqësues të tatimpaguesve në këtë Këshill, të përshkruar në pikën 2 të kreut I të këtij vendimi.

dh) Anëtarët e rinj, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin tatimor, duhet të përfaqësojnë një organizatë ose shoqatë nga i njëjti sektor organizatash ose shoqatash, si ato që përfaqësohen nga anëtarët përfaqësues të tatimpaguesve që largohen në përputhje me përbërjen e Këshillit, të përshkruar në shkronjën "b" të pikës 1 të kreut I të këtij vendimi.

7. Shmangia e konfliktit të interesit:

a) Anëtarët, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, nuk përfitojnë bonus për pjesëmarrjen në mbledhjet e këtij Këshilli apo shpërblime të formave të tjera.

b) Veprimtaria e anëtarit, përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillin Tatimor, duhet t'i përgjigjet rolit të tij si përfaqësues i tatimpaguesve dhe jo interesave të tij personalë.

8. Drejtimi i Këshillit Tatimor:

a) Këshilli Tatimor kryesohet nga dy bashkëkryetarë, përkatësisht zëvendësministri i Financave, që mbulon çështjet e tatimeve, dhe një anëtar, përfaqësues i tatimpaguesve në këtë Këshill.

b) Mandati i zëvendësministrit të Financave, që mbulon çështjet e tatimeve, si bashkëkryetar i Këshillit Tatimor, është i përhershëm.

c) Çdo anëtar, përfaqësues i tatimpaguesve, mund të zgjidhet si bashkëkryetar i Këshillit Tatimor, për një mandat dyvjeçar. Pas këtij mandati, ai humbet të drejtën e rikandidimit për këtë detyrë, për dy vjet, dhe mund të rikandidohet pas kësaj periudhe.

ç) Anëtari, përfaqësues i tatimpaguesve, bashkëkryetar i Këshillit Tatimor, zgjidhet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve përfaqësues të tatimpaguesve në këtë Këshill. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë, me tri kandidatura. Çdo anëtar, përfaqësues i tatimpaguesve, në Këshill, mund të kandidohet ose të propozojë një anëtar tjetër për këtë detyrë. Procesi i zgjedhjes administrohet nga një komision i përkohshëm, i përbërë nga Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor dhe dy anëtarë, përfaqësues të tatimpaguesve, në këtë Këshill, të cilët zgjidhen me short.

d) Anëtari, përfaqësues i tatimpaguesve, i cili del i dyti në konkurrimin për rolin e bashkëkryetarit të Këshillit Tatimor, e zëvendëson bashkëkryetarin, nëse është e nevojshme.

dh) Bashkëkryetarët e Këshillit Tatimor kanë këto përgjegjësi:

i) miratojnë ditën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjeve të Këshillit Tatimor;

ii) drejtojnë mbledhjet e Këshillit Tatimor, sipas një marrëveshjeje paraprake mes tyre;

iii) miratojnë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Tatimor;

iv) finalizojnë dhe miratojnë propozimet e bëra nga Këshilli Tatimor për t'iu paraqitur Ministrit të Financave dhe/apo institucioneve të tjera publike;

v) nënshkruajnë çdo dokument që del në emër të Këshillit Tatimor;

vi )i paraqesin Ministrit të Financave raportin vjetor të punës së Këshillit Tatimor;

vii) përfaqësojnë Këshillin Tatimor në raport me palët e treta, duke përfshirë këtu median dhe publikun.

II. MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TATIMOR

9. Bashkërendimi i punës së Këshillit tatimor-Sekretariat Administrativ:

a) Puna e Këshillit Tatimor bashkërendohet nga Sekretariati Administrativ i Këshillit.

b) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor përbëhet nga:

i) Drejtori i Drejtorisë së Politikave Fiskale, në Ministrinë e Financve.

ii) Përgjegjës i Sektorit të Politikave Fiskale, në Ministrinë e Financave.

c) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale në Ministrinë e Financave.

ç) Zyra e Këshillit Tatimor vendoset në Ministrinë e Financave.

d) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor kryen këto detyra:

i) Administron dokumentacionin që lidhet me përzgjedhjen e anëtarëve përfaqësues të tatimpaguesve në Këshillin Tatimor;

ii) Përgatit rendin e ditës dhe materialet për mbledhjet e Këshillit Tatimor, sipas udhëzimeve të bashkëkryetarëve të Këshillit;

iii) U dërgon anëtarëve të Këshillit kërkesën për të propozuar çështje dhe materiale që mund të merren në shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Këshillit;

iv) U dërgon me postë elektronike, anëtarëve të Këshillit Tatimor njoftimin dhe materialet për mbledhjet e Këshillit;

v) Bashkërendon punën e grupeve të përkohshme të punës, të krijuara në përputhje me shkronjën "ç" të pikës 1 të kreut I të këtij vendimi;

vi) Mban dhe përgatit procesverbalet e mbledhjes së Këshillit Tatimor, si dhe ua paraqet të gjithë anëtarëve të Këshillit, në përfundim të mbledhjes, për nënshkrim;

vii) Përgatit propozimet e Këshillit Tatimor për miratim nga bashkëkryetarët e Këshillit;

viii) I përgjigjet korrespondencës lidhur me veprimtarinë e Këshillit Tatimor;

ix) Arkivon dhe ruan të gjithë dokumentacionin që lidhet me veprimtarinë e Këshillit Tatimor;

x) I informon anëtarët e Këshillit Tatimor për çështje që mund të jenë me interes për ta, në kuadër të kontributit të tyre në këtë Këshill;

xi) Përgatit raportin vjetor të punës së Këshillit Tatimor, në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit të ofruar nga bashkëkryetarët;

xii) Përgatit dhe bashkërendon veprimtari të tjera të Këshillit Tatimor, me miratimin e bashkëkryetarëve;

xiii) Menaxhon punën për sigurimin e fondeve nga burime të jashtme për të mbështetur veprimtaritë e Këshillit Tatimor.

dh) Anëtarët e Sekretariatit Administrativ, për punën e kryer në funksion të mbarëvajtjes së punës së Këshillit Tatimor, marrin një shpërblim në masën 5000 (pesë mijë) lekë për mbledhje. Ky shpërblim përballohet nga buxheti i Ministrisë së Financave.

10. Organizimi i mbledhjeve të Këshillit Tatimor:

a) Këshilli Tatimor mblidhet, të paktën çdo tre muaj dhe jo më pak se katër herë në vit.

b) Sekretariati Administrativ fton në mbledhjet e Këshillit, me propozimin me shkrim, përfshirë edhe përmes postës elektronike, e të paktën dy anëtarëve të Këshillit Tatimor dhe, me miratimin e bashkëkryetarëve të këtij Këshilli, përfaqësues të tjerë të institucioneve publike, të organizatave jofitimprurëse, përfshirë edhe organizatat e biznesit, si dhe ekspertë të pavarur.

c) Në mbledhjen e findit të vitit kalendarik, anëtarët e Këshillit Tatimor shqyrtojnë dhe miratojnë raportin vjetor të punës së këtij Këshilli.

ç) Mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Tatimor mund të mbahet me propozimin, me shkrim, përfshirë edhe përmes postës elektronike, të tre anëtarëve të Këshillit dhe me miratimin e bashkëkryetarëve të Këshillit.

d) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor u dërgon anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Këshillit, kërkesën për të propozuar çështje për rendin e ditës, analiza të shkruara dhe materiale të tjera për mbledhjen e ardhshme.

dh) Mbështetur në propozimet e ardhura nga anëtarët e Këshillit Tatimor, Sekretariati Administrativ i Këshillit, përgatit rendin e ditës dhe materiale për mbledhjen e këtij Këshilli, si dhe ua paraqet për miratim bashkëkryetarëve të Këshillit.

e) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor u dërgon anëtarëve të këtij Këshilli rendin e ditës dhe materialet për mbledhjen e Këshillit të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së mbledhjes.

ë) Këshilli Tatimor merr vendime me konsensus.

f) Mbledhjet e Këshillit Tatimor janë të mbyllura për mediat. Mediat mund të ftohen të ndjekin këto mbledhje vetëm me miratimin paraprak, me shkrim, përfshirë edhe përmes postës elektronike, të 2/3 të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

11. Emri i shkurtuar, adresa dhe vula e Këshillit Tatimor:

a) Emërtimi i shkurtuar i Këshillit Tatimor është KT. Selia e Këshillit Tatimor ndodhet në Ministrinë e Financave, në adresën:Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1, Tiranë.

b) Përmbajtja e vulës së Këshillit Tatimor është: Republika e Shqipërisë, Këshilli Tatimor.

12. Komunikimi i Këshillit Tatimor me palë të treta:

a) Këshilli Tatimor ka logon dhe sloganin e tij, të propozuar nga anëtarët e këtij Këshilli dhe të miratuar nga Ministri i Financave.

b) Komunikimi, në emër të Këshillit Tatimor, me palët e treta, duke përfshirë institucionet publike, institucionet private, organizatat jofitimprurëse, donatorët dhe median, bëhet në mënyrë zyrtare, përmes shkresave me identitet vizual të Këshillit, të firmosura nga dy bashkëkryetarët e këtij Këshilli.

c) Bashkëkryetarët e Këshillit Tatimor mund t'u delegojnë, me shkrim, duke përfshirë edhe përmes postës elektronike, anëtarëve të tjerë të Këshillit, kompetencën për të komunikuar me palë të treta, në emër të Këshillit, duke përfshirë pjesëmarrjen në veprimtari të institucioneve të tjera publike, private dhe joftimprurëse. Në këtë rast, Sekretariati Administrativ i informon paraprakisht të gjithë anëtarët e Këshillit.

ç) Anëtarët përfaqësues të tatimpaguesve, në Këshillit Tatimor, kanë përgjegjësinë për të mbledhur informacion nga tatimpaguesit që përfaqësojnë, për t'u këshilluar me ta lidhur me çështje që trajtohen në mbledhjet e këtij Këshilli, si dhe për t'i informuar këta tatimpagues për vendimet dhe propozimet që dalin nga Këshilli Tatimor.

d) Sipas nevojës dhe mundësive, Sekretariati Administrativ i Këshhillit Tatimor përgatit dhe bashkërendon të gjitha veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun, në emër të Këshillit, me miratimin, me shkrim, përfshirë edhe përmes postës elektronike, të të dy bashkëkryetarëve të këtij Këshilli.

13. Raportimi, botimet dhe faqja në internet.

a) Këshilli Tatimor përgatit një raport vjetor për të bërë analizën e veprimtarisë së tij gjatë një viti, vlerësimin e përparimeve të bëra, si dhe identifikimin e fushave ku mund të bëhen përmirësime.

b) Sekretariati Administrativ i Këshillit Tatimor do të përgatisë raportin vjetor me kontributin e të gjithë anëtarëve të Këshillit. Anëtarët e Këshillit do ta shqyrtojnë dhe miratojnë raportin vjetor gjatë mbledhjes së parë të Këshillit, në vitin pasardhës.

c) Bashkëkryetarët e Këshillit Tatimor do t'ia paraqesin raportin Ministrit të Financave.

ç) Raporti vjetor i Këshillit Tatimor është dokument publik dhe Sekretariati Administrativ i Këshillit e vendos atë në faqet e internetit të Ministrisë të Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Këshillit Tatimor, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune pas miratimit të këtij raporti nga anëtarët e Këshillit.

d) Këshilli Tatimor përgatit dhe boton publikime të ndryshme.

dh) Këshilli Tatimor ka faqen e tij zyrtare të internetit.

III. KONTRIBUTET FINANCIARE

14. Burimet e financimit të Këshillit Tatimor janë:

i) Buxheti i Shtetit;

ii) kontributi i anëtarëve, që përfaqësojnë tatimpaguesit, në këtë Këshill;

iii) burime të tjera të ligjshme financiare, të dhëna në formë donacioni nga institucione ose nga organizata kombëtare a ndërkombëtare, për financimin e veprimtarive që lidhen me objektin e këtij Këshilli.

15. Kostot e zyrës së Këshillit Tatimor mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Financave.

16. Këshilli Tatimor mund të përdorë burime të tjera të ligjshme financiare, materiale ose ndihmë teknike nga institucione apo organizata kombëtare a ndërkombëtare, për financimin e veprimtarive që lidhen me objektin e vet të veprimtarisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**
**Nr.27, datë 18.8.2010**

## PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.24, DATË 2.9.2008 ”PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 75/1.4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore rezulton me situatë kreditore të TVSH-së, e cila ka plotësuar kushtet ligjore për t'u rimbursuar dhe njëkohësisht në administratën doganore me situatë debitore për TVSH-në e shtyrë në import për makineri e pajisje me cikël të zhvillimit të investimit dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit mbi 12 muaj, për të cilat është aplikuar skema e shtyrjes sipas përcaktimeve të sesionit I/I të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH-sh.a., ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Ministrit të Financave, në të cilën të kërkojë destinimin e shumës së TVSH-së së konfirmuar si të rimbursueshme nga organet tatimore, për likuidimin e shumës së TVSH-së debitore që ka në administratën doganore. Me paraqitjen e kërkesës nga tatimpaguesi, Ministria e Financave u kërkon informacion strukturave përkatëse doganore dhe tatimore, lidhur me situatën e tatimpaguesit, sipas dokumentacionit:”

2. Në pikën 133, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Për të gjitha shkeljet që ndodhin në periudhat pas hyrjes me fuqi të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pavarësisht nga momenti i konstatimit, do të aplikohen dënimet administrative në fuqi në momentin e kryerjes së shkeljes.”

Në pikën 106 “Objekti i ankimit administrativ tatimor”, paragrafi 106.4.2. ndryshohet me këtë përmbajtje.

“106.4.2. Drejtoria e Apelimit Tatimor i dërgon një kopje të ankimit me postë apo në formë elektronike organit të administratës tatimore që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë aktin administrativ në fjalë”.

Në pikën 107 “Pagesa e tatimit objekt ankimi administrativ tatimor” paragrafi 107.3.2 ndryshohet me këtë përmbajtje.

“107.3.2. Në qoftë se tatimpaguesi bën ankim kundër një detyrimi tatimor dhe në të njëjtën kohë ka paraqitur një kërkesë për kompensim detyrimi (nëpërmjet së cilës ka argumentuar kompensimin e detyrimit tatimor që ankimohet me tatime të paguara tepër apo tepricë kreditore nga periudha të mëparshme), në zbatim të neneve 75 dhe 107 të ligjit, Drejtoria Rajonale Tatimore është e detyruar që brenda një periudhe jo më shumë se 15 ditë kalendarike, t’i konfirmojë me shkrim tatimpaguesit për kompensimin e detyrimit objekt apelimi ose per moskryerjen e kompensimit.

Në pikën 108 “Veprimet e ndërmarra nga Drejtoria e Apelimit Tatimor lidhur me ankimin”, paragrafi 108.4 ndryshohet me këtë përmbajtje.

“108.4. Ankimuesi ka të drejtë nese e kërkon, të paraqitet vetë ose me përfaqësues në Drejtorinë e Apelimit Tatimor për të dhënë argumente dhe sqarime që ndihmojnë në trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të akimimit.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|---|
| KODI PENAL .......................................................................... | 226 lekë |
| KODI I PROCEDURËS PENALE................................................ | 330 lekë |
| PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË | 660 lekë |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |
| PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME | 328 lekë |
| PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE ....... | 260 lekë |
| VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË ........................ | 512 lekë |

Hyri në shtyp më 26.8.2010
Doli nga shtypi më 27.8.2010

| Tirazhi: 2300 copë | Formati: 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë